



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH dhe shoqërisë Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkresa me Nr. 377 Prot., protokoll i AK-së, datë 22.10.2020, “Përqendrimi nëpërmjet transaksionit të blerjes së HMP Medizintechnik GmbH dhe Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH nga ana e Messer Medical Home Care Holding GmbH”, me të cilën jemi njoftuar mbi transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërive Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH dhe Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH nga shoqëria Messer Medical Home Care Holding GmbH.

Sipas Marrëveshjes së Shitjes dhe Transferimit të Aksioneve, të nënshkruar më datë 29 shtator 2020, palët janë:

Blerësi : Messer Medical Home Care Holding GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Taunus, Gjermani dhe me numër regjistrimi HRB 6810. Objekti i shoqërisë është administrimi i pasurive të veta, blerja, mbajtja dhe administrimi i investimeve, në veçanti mbajtja dhe administrimi i shoqërive në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shitjes së gazrave të të gjitha llojeve, produkteve mjekësore, pajisjeve laboratorike si dhe shërbimet e lidhura me to, etj. Kjo shoqëri është pjesë e Messer Group GmbH.

Messer Group GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Frankfurt, Gjermani dhe me numër regjistrimi HRB 73307. Objekti i shoqërisë është zhvillimi, prodhimi dhe shitja e gazrave të çdo lloji, gazrave mjekësore dhe pajisjeve laboratorike etj.

Messer Group është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar prej tij Messer Albagaz SHPK.

Messer Albagaz SHPK, një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i aktivitetit të saj është prodhimi, shpërndarja dhe shitja e gazrave industrial, mjekësor dhe speciale si dhe të pajisjeve që lidhen me to, etj.

Garantuesi: MIG Holding GmbH me seli në Taunus, Gjermani dhe me numër regjistrimi HRB 6413, ka si objekt të veprimtarisë mbajtjen, menaxhimin dhe blerjen e aksioneve në shoqëri që janë veçanërisht aktive në fushat e zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të makinerive, aparateve,

pajisjeve dhe materjaleve shtesë për teknologji saldimi dhe prerje, pajisje mjekësore dhe pajisje laboratorike si dhe shërbimet përkatëse të ndërlidhura me to. Objekti i shoqërisë përfshin në veçanti financimin e shoqërive në të cilat ka pjesëmarrje.

Shitësi: Hans Müller, i lindur më 21 Mars 1962 dhe banues në Nurnberg, Gjermani

Target 1: Hans Müller HMP Medizintechnik GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër regjistrimi HRB 25169 dhe me seli në Nurenberg. Kjo shoqëri zotërohet nga Z. Hans Müller. Objekti i shoqërisë është shitja e pajisjeve mjekësore me fokus në pneumologji, terapi intensive dhe për kujdesin në shtëpi.

Target 2: Hans Müller medizinische und technische Gase GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër regjistrimi HRB 27165 dhe me seli në Nurenberg. Kjo shoqëri zotërohet nga Z. Hans Müller. Objekti i shoqërisë është shitja e gazeve mjekësore dhe teknike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.